

VENDIM
Nr. 647, datë 31.10.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2018, zëri “Shërbime qeveritare”, t’i shtohet fondi prej 15 033 538 (pesëmbëdhjetë milionë e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) lekësh, për organizimin e eventeve në kuadër të përmbylljes së “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut” për periudhën nëntor 2018.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama